

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial

P2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI

Data 08.07.2017

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	25	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	10	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Kompania "VISION" prodhon korniza për fotografi për tregun me pakicë të Evropës. Kompania përdor sistemin standard variabil (marxhinal) të kostove dhe kjo i mundëson kompanisë të kontrolloj efikasitetin e kostove dhe të përcaktoj më lehtë politikatat e çmimeve. Produkti i saj më i njohur është korniza e quajtur "Art Deco". Kompania e blen kornizën e para-formuar (e cila përfshin pjesën e përparme dekorative dhe një pllakë të drurit mbrapa) nga Kina dhe xhamin e pastër e fikson në kornizë me grepa prej bronzi. Më poshtë kemi informatat e buxhetuara për produktin "Art Deco" për muajin Mars.

	Për njësi	Total
Shitjet	14.50	72,500
Zbritur Kostot:		
Korniza e para-formuar	3.55	(17,750)
xhami (0.25 m2 për kornizë @ €3.40 për metër katror)	0.85	(4,250)
Grepa nga Bronzi (2 grepa për kornizë @ €0.65 secili)	1.30	(6,500)
Puna direkte (0.25 orë për kornizë @ €11 për orë)	2.75	(13,750)
Shpenzimet e përgjithshme variabile (0.25 orë për kornizë @ €1.30 për orë pune)	0.325	(1,625)
		<u>(8,725)</u>
Shpenzimet e përgjithshme fikse		
Fitimi		19,900

Në muajin Mars, kompania ka prodhuar dhe shitur 4,960 korniza të tipit "Art Deco" dhe ka regjistruar rezultatet e mëposhtme aktuale:

Shitjet	72,912
Zbritur Kostot:	
Korniza e para - formuar (@ €3.50 secila)	(17,360)
xhami (bazuar në 1,250 metra katror)	(4,275)
Grepa nga Bronzi (@ €0.625 secili)	(6,200)
Puna direkte (bazuar në 1,220 orë)	(13,481)
Shpenzimet e përgjithshme variabile (bazuar në orë të punës direkte)	(1,647)
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit	<u>(8,215)</u>
Fitimi	21,734

Drejtori menaxhues i kompanisë është i kënaqur pasi që fitimi aktual është më i madh se fitimi i buxhetuar dhe ai kërkon nga ju që ti ndihmoni në sqarimin e faktorëve që kanë ndikuar në këtë.

KËRKOHET:

Duke i shfrytëzuar informatat e dhëna për muajin Mars:

- (a) Përgatiteni një pasqyre të të ardhurave, bazuar në sistemin variabil (marxhinal) të kostove për buxhetin fiks, fleksibil dhe rezultateve aktuale. (6 pikë)
- (b) Bazuar në informatat e dhëna, kalkuloni variancat. (16 pikë)
- (c) Përgatiteni një pasqyrë të ri konsolidimit të fitimit nga buxheti fiks me fitimin aktual. (3 pikë)

**[Total: 25
Pikë]**

Zgjidhja 1

a) Pasqyra e fitimit

Njësi	5,000	4,960	4,960	Variance
	<u>Buxheti Fiks</u>	<u>Buxheti fleksibil</u>	<u>Rezultati</u>	
	€	€	€	
Shitjet	72,500	71,920	72,912	992
Zbritur Kostot variabile:				
Korniza e para-formuar	-17,750	-17,608	-17,360	248
Xhami	-4,250	-4,216	-4,275	-59
Grepa nga Bronzi	-6,500	-6,448	-6,200	248
Puna Direkte	-13,750	-13,640	-13,481	159
Shp.p.variabile	-1,625	-1,612	-1,647	-35
Total, shpenzimet variabile	<u>-43,875</u>	<u>-43,524</u>	<u>-42,963</u>	<u>561</u>
Fitim Kontributi	28,625	28,396	29,949	1,553
Shp. Përgj. fikse	-8,725	-8,725	-8,215	510
Fitimi	<u>19,900</u>	<u>19,671</u>	<u>21,734</u>	<u>2,063</u>

6 pikë

b) Kalkulimi i variancave

Korniza e para formuar

Variance e çmimit

$(SP - AP) \times AQ$

$$= (\text{€}3.55 - \text{€}3.50) \times 4,960 = 248 \text{ F}$$

Variance e përdorimit

$(SQ - AQ) \times SP$

$$= (4,960 - 4,960) \times \text{€}3.5 = 0$$

Xhami

Variance e çmimit

$(SP - AP) \times AQ$

$$= (\text{€}3.40 - (\text{€}4,275/1,250)) \times 1,250 = -25 \text{ A}$$

Variance e përdorimit

$(SQ - AQ) \times SP$

$$= ((4,960 \times 0.25) - 1,250) \times \text{€}3.40 = -34 \text{ A}$$

Grepa nga Bronzi

Variance e çmimit

$(SP - AP) \times AQ$

$$= (\text{€}0.65 - \text{€}0.625) \times (4,960 \times 2) = 248 \text{ F}$$

Variance e përdorimit

$(SQ - AQ) \times SP$

$$= ((2 \times 4,960) - (2 \times 4,960)) \times \text{€}0.65 = 0$$

Variance e çmimit të punës

$(SR - AR) \times AH$

$$= (\text{€}11 - (\text{€}13,481/1,220)) \times 1,220 = -61 \text{ A}$$

Variance e efikasitetit të punës

$(SH - AH) \times SR$

$$= ((0.25 \times 4,960) - 1,220) \times \text{€}11 = 220 \text{ F}$$

Variance e çmimit të shp.përgj.

variabile $(SR - AR) \times AH$

$$= (\text{€}1.30 - (\text{€}1,647/1,220)) \times 1,220 = -61 \text{ A}$$

Variance e efikasitetit të shp.përgj.

variabile $(SH - AH) \times SR$

$$= ((0.25 \times 4,960) - 1,220) \times \text{€}1.30 = 26 \text{ F}$$

Varianca në shpenzime fikse (BFO - AFO)
 = (8,725 - 8,215) = 510 F

Varianca e çmimit të shitjes
 (AP - SP) x AV
 = ((€72,912/4,960) - €14.50) x 4,960 = 992 F

Total variancat (pa variance e vëllimit) 2,063 F

Varianca e volumit të shitjes (AV - BV) x SM
 = (4,960 - 5,000) x €5.725** = -229
 A

Variancat Totale 1,834
 F

16 pikë

** Fitimi Standard = €28,625 Fitimi I buxhetuar/5,000 njësi = €5.725 për njësi

c) Rikonsolidimi i Fitimit Aktual dhe të Buxhetuar

	€
Fitimi i buxhetuar (5,000 njësi)	19,900
Varianca e volumit të shitjes A	-229
	<u>19,671</u>
Fitimi sipas buxhetit fleksibil (4,960 njësi)	19,671

3 pikë

Totali i variancave tjera duke e përjashtuar atë të volumit të shitjes 2,063 F

Fitimi aktual (4,960 njësi) 21,734

Total 25 Pikë

Problemi 2

1. Lela Co. është një kompani ndërtimit dhe po mendon të aplikojë sistemin e llogaritjes së Sasisë së Porosis Ekonomike (SPE) në furnizimet me materialin kryesor të saj B12. Departamenti i blerjeve ka kalkuluar e porositjes që është 30€ për një porosi të materialit B12 dhe kostot e mbajtjes janë vlerësuar të jenë 20% e çmimit të blerjes së materialit. Materiali B12 kushton të blihet 42€ për njësi. Kompanisë i nevojiten 15,000 njësi në vite të materialit B12. Kalkuloni Sasinë e porosis ekonomike, koston e mbajtjes dhe të porositjes në vite. (rrumbullakosni vlerat):

INFORMATAT E MËPOSHTËME LIDHEN ME PYETJET 2,3 DHE 4:

Dugi Co. është duke shqyrtuar pranimin e një kontrate afatshkurtër për prodhimin e çelësave. Për prodhimin e çelësave nevojiten tre lloje materiale dhe kompania këto materiale i zotëron në gjendje të stokut sipas tabelës më poshtë:

Materiali	Njësi në stoqe	Çmimi kushtues në Kg	Vlera e shitjes si mbeturin Kg	Kostoja e zëvendësi mit për kg
AB	1,000 Kg	€4.00	€3.00	€4.25
CD	250 Kg	€2.75	€1.20	€3.20
EF	3,000 Kg	€1.50	zero	€2.95

2. Vlerësoni që materiali AB është material që përdoret rregullisht nga kompania dhe kërkohen 1,750 kg nga ky material për prodhimin e çelësave. Sa janë kostot relevante nga ky material për kontratën afatshkurtër ? Tregoni kalkulimet:
3. Vlerësoni që materiali CD nuk përdoret rregullisht në kompani dhe kërkohen 500 kg nga ky material për përfundimin e kontratës afatshkurtër për prodhimin e çelësave. Sa janë kostot relevante nga ky material për kontratën afatshkurtër ? Tregoni kalkulimet:
4. Vlerësoni që materiali EF nuk përdoret më nga kompania. Nevojiten 2,500 kg të këtij materiali për të përfunduar prodhimin e çelësave për kontratën afatshkurtër. Sa janë kostot relevante nga ky material për kontratën afatshkurtër ? Tregoni kalkulimet:
5. Tuki Co ka informatat e mëposhtëme në kontabilitetin e tij për vitin:

	Janar	Qershor	Nëntor
Kostot e shitjes dhe administrative	€25,504	€34,189	€40,558
Sasia e shitjeve në njësi	4,250	6,500	8,150

Sa është pjesa fikse e kostove të shitjes dhe administrative :

Zgjidhja 2

1.

$\sqrt{2DO/H}$

D = Kërkesa vjetore 15,000 njësi

Çmimi për porosi = €30

H = Kosto e mbajtjes për vite = 20% x €42 = €8.40

SPE = 327 njësi

Kostot e mbajtjes = $(327/2) \times 8.4 = 1,373$

Kostot e porositjes = $(15,000 / 327) \times 30 = 1,373$

2.

Kostot relevante :

$1,750 \text{ Kg} \times €4.25 = €7,437.50$ pasi që materiali i shfrytëzuar për kontratën duhet të zëvendësohet pasi që ka përdorim të rregullt në kompani

3. Kostot relevante : $(250 \text{ Kg} \times €1.20) + (250 \text{ Kg} \times €3.20) = €1,100.$

4. Zero (Vlera e shitjes në stoqe e materialit EF është zero)

5

	Sasia e shitjeve	Shp. Shit. Dhe admin.
Lartë - nëntor	8,150	€40,558
Ulët - janar	4,250	€25,504
Ndryshimi	3,900	€15,054
KV/NJ = €15,054/3,900 = €3.86 për njësi		
Kostot fikse = €40,558 - (8,150 x €3.86) = €9,099		

Problemi 3

Lani Co prodhon një produkt të vetëm i quajtur Kufje dhe përdorët në industrinë muzikore. Kompania është duke projektuar planet për periudhën e ardhshme financiare: për vitin që përfundon më 31 Gusht 2018.

Drejtorët janë të shqetësuar për të siguruar profitabilitetit dhe vazhdimësinë dhe kanë një numër të pyetjeve dhe propozimeve për të cilat ata kërkojnë këshilla.

Informacioni i mëposhtëm është ofruar për Kufje , për vitin që përfundon më 31 gusht 2018:

- 70,000 njësi të produktit pritet të jenë shitjet me një çmim mesatar të shitjes prej 12 € për njësi.
- Kostot e prodhimit janë të buxhetuara në 560,000 € nga të cilat 70,000 € konsiderohen si kosto fikse.
- Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes janë të buxhetuara në 141,250 € nga të cilat 61,250 € konsiderohen si kosto variabile.
- shpenzimet e administratës janë të buxhetuara në € 35,000 kosto fikse plus 8,750 € variabile duke i dhënë një total prej 43,750 €.

KËRKOHET:

- (a) Kalkuloni Pikën e Rentabilitetit në njësi dhe Marzha e Sigurisë bazuar në buxhetimin origjinal në të dhënat e mësipërme. (6 pikë)
- (b) Kalkuloni ndikimin e pritur në fitim, nëse kërkesa për shitjet rritet për 15%. (3 pikë)
- (c) Lani Co, është vlerëson informatat e marra nga tregu që tregojnë se kompania mund të zbret çmimin e shitjes për 1 euro, kërkesat e tregut rriten për 8,000 njësi dhe kostot fikse të rriten për 20%. Gjithashtu kompania mund të rritë çmimin e shitjes për 1 euro dhe kërkesat e tregut bien për 10,000 njësi dhe kostot fikse zbriten për 10%. Tregoni planin e prodhimit dhe shitjes që maksimizon fitimin dhe sa do të jetë pika e rentabilitetit në njësi dhe të hyra sipas këtij plani dhe marzha e sigurisë në përqindje në pikën që maksimizon fitimin. Tregoni kalkulimet. (11 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja 3

Pjesa (a)

Analiza e Kostove	Fikse	Variabile	Total
Kostot e prodhimit	70,000	490,000	560,000
Kostot e shitjes dhe shpërndarjes	80,000	61,250	141,250
<u>Kostot Administrative</u>	<u>35,000</u>	<u>8,750</u>	<u>43,750</u>
	185,000	560,000	745,000

Çmimi i shitjes për njësi	€12
Kostot variabile për njësi	$(560,000/70,000) = €8$
Fitimi kontributi për njësi	€4
Pika e rentabilitetit në njësi = Kostot fikse =	$€185,000 = 46,250$ njësi
Kontributi	€4

Marxhina e Siguris:

Prodhimi i buxhetuar =	70,000 njësi
Pika e Rentabilitetit =	46,250 njësi
Diferenca =	23,750 njësi
Marxhina e Siguris =	$23,750$ njësi ose $23,750/70,000 = 39.92\%$ (6 pikë)

Pjesa (b)

Një rritje në kërkesen e shitjeve prej 15% do të rritë shitjet në 80,500 njësi nga 70,000 njësi.

Kontributi i pritur	$(80,500 \times €4) = €322,000$
<u>Kostot Fikse (pa ndryshim) =</u>	<u>€185,000</u>
Fitimi i pritur nga rritja e shitjeve	137,000 (3 pikë)

Pjesa (c)

Fitimi aktual $(70,000 \times 4) - 185,000€ = 95,000$

Rritje e çmimit të shitjes + 1€; $(60,000 \times 5) - (185,000 \times 0.9) = 136,200$

Zbritje e çmimit të shitjes - 1€; $(78,000 \times 3) - (185,000 \times 1.2) = 12,000$

Rekomandohet rritje e çmimit të shitjes - Pr = $(166,500/5) = 33,300$; Msig = $60,000 - 33,300 = 26,700$

Msig% = $26,700 / 60,000 = 44.5\%$

Problemi 4

Lika Kompani përvetëson shpenzimet e përgjithshme të prodhimit në bazë të orëve direkte të punës.

Më 31, Dhjetor llogaria e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit tregonte një saldo të nën aplikimit prej €40,000. Kompania ka vlerësuar se gjatë vitit duhej të shfrytëzoheshin 300,000 orë të punës direkte. Numri aktual i orëve të punës direkte ishte 320,000.

Në kartën e punës në proces janë regjistruar €840,000 të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit aktuale të cilat ishin transferuar në llogarinë e produkteve të gatshme. Nuk kishte punë në proces në fillim të vitit dhe në fund të vitit,

Kërkohet

- Kalkuloni koeficientin e përvetësimit (absorbimit) të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit? (4 pikë)
- Sa kanë qenë shpenzimet e përgjithshme të prodhimit të buxhetore në fillim të periudhës? (6 pikë)

[Total: 10 pikë]

Zgjidhja

a. $(840,000 - 40,000) / 320,000 = 2.5€ / \text{orë}$

b. $(300,000 \text{ orë} \times 2.5€ / \text{orë}) = 750,000€$

Problemi 5

Noka Kompani prodhon griz nga orizi. Kompania perdor llogarit e procesit te prodhimit. Stoqet fillestare ne shkurt ishin 1,000 njesi dhe ishin te kompletuara 100% sa i perket kostove te materialit dhe 75% sa i perket kostove te shnderrimit (Konvertimit). Stoqet fillestare kishin nje kosto te regjistruar prej €2,900 per materiale dhe €1,800 per kostot e shnderrimit (konvertimit). Gjatë muajit shkurt kompania kishte futur në prodhim 12,650 njësi dhe prej tyre i kishte kompletuar dhe transferuar jashtë 10,000 njësi. Stoqet në fund të Shkurtit ishin 75% të kompletuara kostove të shndërrimit (Konvertimit) dhe 100% të kompletuara sa i përket materialeve direkte. Nuk kishte humbje në proces të prodhimit. Në kompani gjatë Shkurtit kishin ndodhur €37,950 kosto e materialit dhe kostot e shndërrimit (konvertimit) ishin 28,770€. Kompania aplikon metodën FIFO.

Kërkohet - Kërkohet

- Njësit ekuivalente dhe çmimin e për njësit ekuivalente për materialet (4 pikë)
- Njësit ekuivalente dhe çmimin e për njësit ekuivalente për kostot e konvertimit (Shndërrimit) (4 pikë)
- Kostot e produkteve të prodhuara (transferuara jashtë) (6 pikë)
- Kostot e stoqeve në fund (6 pikë)

[Total: 20 Pike]

Zgjidhja

- 12,250 njësi ekuivalente ; $37,950/12,650 = 3\text{€}/\text{njësi ekuivalente}$
- $(1,000 * 0.25) + 9,000 + (3,650 * 0.75) = 11,987.5\text{€}$ njësi ekuivalente ; $28,770/11,987.5 = 2.4$
- $(2,900 + 1,800) + (250 \times 2.4) + [9,000 \times (3 + 2.4)] = 53,900\text{€}$
- $(3,650 \times 3) + [(3,650 \times 0.75) \times 2.4] = 17,520\text{€}$